



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.192/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e paraqitura nga Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate (NISMA), Konservatorët, Intelktualët, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 27.01.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. Refuzohen si të pa bazuara ankesat e Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate (NISMA), Konservatorët, Intelktualët, me seli në Prishtinë, Anr.192/2025 dhe Anr.193/2025.

A r s y e t i m

Me datë 25.01.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuara me numër Anr.192/2025, Anr.193/2025, të parashtruara nga koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate (NISMA), Konservatorët, Intelktualët, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë.

-Në ankesën A.nr.192/2025, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate (NISMA), konservatorët, Intelktualët, pretendon se me datë 24.01.2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka organizuar në tubim elektorale në komunën e Dardanës i cili aktiviteti konfirmohet edhe nga postimi i publikuar në rrjetin social Facebook nga kandidati për deputetë z.Albin Kurti i cili ka ndarë detaje dhe momente nga ky tubim e po ashtu edhe nga fotoja e publikuar nga faqja zyrtare e LVV-së, në të cilin tubim janë evidentuar raste të pjesëmarrjes së fëmijëve nën moshën pesëmbëdhjete(15) vjeç. Për më tepër një sjellje e tillë është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe vendore që mbrojnë të drejtat e fëmijëve, duke rrezikuar mirëqenien dhe interesin e tyre më të mirë. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi.

-Në ankesën Anr.193/2025, koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate (NISMA), konservatorët, Intelektualët, pretendon se më 24 janar 2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka organizuar një tubim elektoral në komunën e Vitisë, aktivitet ky që konfirmohet nga postimi i publikuar në rrjetin social facebook nga kandidati për deputetë z. Faton Peci, i cili ka ndarë detaje dhe momente nga ky tubim e po ashtu edhe nga fotoja e publikuar nga faqja zyrtare e LVV-së në të cilin tubim janë evidentuar raste të pjesëmarrjes së fëmijëve nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi.

Parashtruesi i ankesave thekson se me këto veprime kandidati dhe subjekti politik LVV kanë bërë shkelje të nenit 5, paragrafit 3 të Rregullores për Fushatën Zgjedhore nr. 07/2024 ku parashihet se *“Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjete (15)vjeç në Fushatën Zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore nuk mund të behët pa prezencën apo pëlqimin e prindërve”*.

Më datë 26.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 27.01.2025 në ora 12:00. Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 27.01.2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), e ka kundërshtuar ankesën i të pabazuar me pretendimin se fakti publikimi i disa fotove në tubimet elektorale në Viti dhe Dardanë, në të cilat vërehen fëmijët nuk qëndron aspak dhe është jashtë standardeve të kërkuara edhe me nenin 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024.

Parashtruesi i ankesës ka theksuar se siç vërehet edhe nga provat e bashkangjitura të pretenduesit, LVV, nuk është e ndërlidhur me angazhimin e fëmijëve në fushata, gjithashtu për më shumë fëmijët shihen në prezencën e prindërve pjesëmarrës në ngjarjet në këtë drejtim veprimi i kandidatit për kryeministër dhe deputetë z. Albin Kurti dhe kandidatit për deputetë z. Faton Peci janë në përputhje të plotë me rregullat zgjedhore, përkatësisht me nenin 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës dhe Deklarimin Financiar si dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.192/2025, A.nr.193/2025, të paraqitura me datë 25.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.192/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate (NISMA), konservatorët, Intelektualët, kundër subjektit të njëjtë politik LVV, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se subjekti politik në fjale nuk ka bere shkelje të nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores NR.07/2024, i cili përcakton sePjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të behet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve. Mbi bazën e provave me saktësisht fotografitë e paraqitura nuk mund të vërtetohet se fëmijët kane qene pa përcjelljen e prindërve. Me në fotografitë e ofruara si prova me fëmijë shifen edhe persona madhor qe mund të konsiderohen se kanë qene prindërit e tyre. Ne anën tjetër neni 117 par. 3 LZP, kur vendos për ankesat PZAP bazohet në prova të qarta dhe bindëse. Prandaj nuk qëndrojnë pretendimet e theksuara në ankesë.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 te LZP-së, nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores NR.07/2024, për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.192/2025 më datën 27.01.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.